

CONTRASTIVE ANALYSIS OF RELATIVE CLAUSES IN ALBANIAN AND ENGLISH – STRUCTURE AND USAGE



Syntax

Keywords: grammatical knowledge, Albanian language, English language, syntactic category, word, sentence, clause, relative clause.

Nerxhivane Ramadani

State University of Tetova. English Department. North Macedonia.

Abstract

The correct use of languages by speakers includes a complex system of grammatical knowledge. A basic fact about words in all languages is that, although they are many in number, they can still be grouped into a relatively small number of classes called syntactic categories. The linguistic aspect where it becomes more apparent than in any other aspect, is the way of connecting words of a language to form grammatical sentences. In this thesis we have dealt precisely this system of rules and categories on which sentences are built in every language. Within this system of rules, we treat the categories of clauses in this case, the relative clauses, their role in extended sentence, their role in complex sentences, their function and their position within the sentences. This treatment will be comparative between two languages, Albanian and English, where the description of linguistic phenomena will be not only descriptive but also explanatory, and where we will try to enter into the linguistic phenomena of the above-mentioned syntactic terms in these two languages, by clarifying the common grammatical principles in both languages and, on the other hand, on the features and specifications of each of them. Generally speaking, compared to Albanian, English language is more explored. For this reason, some syntax phenomena of the Albanian language, in this paper, are analyzed from an empirical point of view, which makes the further researches in this area, indispensable.

Hyrje

Gjatë procesit të të mësuarit të një gjuhe të huaj, rol të rëndësishëm luan edhe njohja e çështjeve gramatikore të cilat paraqesin një mbështetje të fortë gjatë gjithë procesit të të mësuarit, parë nga vështrimi i sistematizimit, implementimit të njohurive të fituara si dhe elokuencën për t'i shprehur këto njohuri. Nevoja për të hulumtuar gramatikën e një gjuhe të veçantë posaçërisht të studiuarit e fushës së sintaksës ndjehet pothuajse nga çdo ligjërues, mësimdhënës të asaj gjuhe të huaj, e në rastin tonë të gjuhës angleze.

Gjatë studimit të sintaksës nuk studion një fenomen ekzotik të natyrës, por në fakt studion vetveten. Studimi i sintaksës na mundëson që në mënyrë të ndërgjegjshme të bëjmë një numër të madh aktivitetesh nga më të thjeshtat e deri te ato më të ndërlikuarat.

Sintaksa në thelb është një lëndë mjaft interesante. Bota është e stërmëbushur me leksione e të dhëna linguistike për shembull një bisedë telefonike mes dy tinxherëve paraqet gjuhë, një etiketë e ngjitur në një shishe shamponi paraqet gjuhë, si dhe e-mail mesazhet, stripet komike të gjitha janë gjuhë. Kjo e bën sintaksën aq të ndritshme, aq të komplikuar por akoma tërheqëse për ta studiuar dhe gjurmuar.

Çdo shkencë ka objektin e vet të studimit. Gjërat dhe fenomenet e botës reale nuk janë të thjeshta, po në aspekte të ndryshme janë tejet të ndërlikuara, ato nuk janë të ndara nga njëra tjetra por janë të lidhura dhe të bashkërenditura në një sistem rregullash të cilat duhet respektuar. Sintaksa, si pjesë dytësore e gramatikës nuk mund të ketë diç tjetër për objekt studimi se atë që ka dhe gramatika, gjuhën, por në një aspekt të veçantë, në aspektin sintaktik.

Metodologjia e punimit

Qasja e këtij punimi do të jetë krahasuese dhe përshkruese. Hulumtuesja u përpoq që sa më qartë t'i formuloj dallimet dhe analizat e vëzhguara duke u bazuar në shembuj nga libra të ndryshëm të gjuhës angleze dhe asaj shqipe. U analizuan fjali të ndryshme të marra nga mbështetje gramatikore për t'u analizuar, si edhe fjali të marrura nga romani "The old Man and the Sea" e shkrimtarit Ernest Hemingway (Plaku dhe deti, në përkthim të Ylber Pinjollit), në të dy gjuhët. Nxjerrja në pah e ngjashmërive dhe dallimeve midis fjalive të varura përcaktore (relative) në gjuhën shqipe dhe angleze në funksionet tyre do të jetë e një rëndësie të veçantë në arritjen e përfundimeve për të vërtetuar hipotezën e parashtruar.

a). Subject – Kryefjalë

Përemrat lidhorë funksionojnë së pari si subjekt i klauzolave mbiemrore. Subject është një fjalë, frazë ose klauzolë që kryen veprimin ose vepron mbi foljen që funksionon si kallëzues. Merrni për shembull dy fjali të mëposhtme:

- The book belongs to me.

- The book is on the table.

Këto dy fjali mund të kombinohen në një fjali të vetme me ndihmën e një përemri lidhor. Së pari, përemri lidhor e zëvendëson subjektin *the book* në fjalinë e dytë për të formuar klauzolë mbiemrore *that is on the table*. Pastaj, klauzola mbiemrore bashkëngjitet emërit *the book* për të formuar fjalinë *The book that is on the table belongs to me*. Përemri lidhor *that* ende i referohet emrit *the book* dhe kjo e bën përemrin lidhor *that* subjekt të klauzolës mbiemrore.

b). Objekt i drejtpërdrejtë – kundrina e drejte – DO

Përemrat lidhorë së dyti funksionojnë si objekt i drejtpërdrejtë i klauzolave mbiemrore. Një objekt i drejtpërdrejtë është një fjalë, frazë apo klauzolë që ajo ndjek dhe merr veprimin e një folje kalimtare. Merrni për shembull dy fjali të mëposhtme:

- The cupcake was poisoned.

- The wicked queen ate the cupcake.

Këto dy fjali mund po ashtu të kombinohen në një fjali të vetme me ndihmën e një përemri lidhor. Së pari, përemri lidhor e zëvendëson objektin e drejtpërdrejtë *cupcake* në fjalinë e dytë për të formuar klauzolën *the wicked queen ate that*. Pastaj, përemri lidhor vendoset në fillimin të klauzolës për të formuar klauzolën mbiemërore *that the wicked queen ate*. Së fundi, klauzola mbiemërore i bashkëngjitet emrit *cupcake* në fjalinë e parë për të formuar fjalinë *The cupcake that the wicked queen ate was poisoned*. Përemri lidhor *that* ende i referohet emrit *cupcake* dhe kjo e bën përemrin lidhor *that* objekt të drejtpërdrejtë të klauzolës mbiemërore.

Pesë përemrat lidhorë që mund të shërbejnë si objekt i drejtpërdrejtë i një klauzole mbiemërore janë: *that, whom, which, Ø* dhe informally *who*. Shembuj të tjerë përemërash lidhorë që funksionojnë si objekte direkte:

- The teacher *whom* the school nominated for the prize already won last year.
- Your girl must like the little boy *Ø* she kissed.
- The crack, *which* Mark discovered, is only minor.
- The baby *whom* his wife watches is their son.

The main clause Hypotheses – Hipoteza mbi fjalinë kryesore

Është më se i njohur fakti që llojet e fjalive të varura përcaktore kanë përdorim plotësisht të ndryshëm: në gjuhën angleze dallojmë dy lloje të këtyre fjalive, restrictive relative clause-sifjalitë përcaktore kufizuese dhe nonrestrictive/appositive relative clauses-sifjalitë përcaktore ndajshimore.

Në mes këtyre dy llojeve të sifjalive ekziston një numër i konsiderueshëm i dallimeve që duhet të mirren parasysh dhe mu për këtë shkak duhet të zgjidhen kufizimet mbi variablen.

Për sa i përket literaturës së fundit të gramatikës gjenerativiste janë parashtruar dy hipoteza të ndryshme që lidhen me strukturën e thellë të sifjalive përcaktore ndajshimore. (There are two different hypotheses for the deep structure of appositive relatives):

Njëra prej tyre quhet “the bar notion” e propozuar nga Jackendoff dhe më vonë Joseph E. Emonds e quan këtë nocion Subordinate Clause Hypotheses SCH - Hipoteza mbi fjalinë e nënrenditur dhe tjetra quhet The Main Clause Hypotheses MCH- Hipoteza mbi fjalinë kryesore. Ai është i pari i cili e parashtron këtë hipotezë pas nocionit mbi Parenthetical Formation Transformation- Futja e fjalive në kllapa.

Një ndër problemet tejet të ndërlikuara është se si sifjalitë përcaktore ndajshimore do të interpretohen. Sipas analizave të lingvistit të shquar Chomsky, shpjegimi mbi përemrin lidhor është bërë brenda NP-noun phrase përbërësit emëror; Struktura e thellë e përemrit lidhor është kopje e paraprijësit. Sintaksa ka për objekt ligjërimitin e lidhur. Fjalët në procesin e ligjërimit, duke

u bashkuar për të shprehur e transmetuar mendimin, hynë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore.

Përfundime dhe rekomandime

Pjesa e fundit e punimit vjen si përfundim logjik i trajtimit të sifjalive përcaktore në gjuhën shqipe dhe angleze, roli i tyre në fjali dhe periudha, me kujdes të veçantë ndaj fjalive të nënrenditura, pasiqë të sifjalitë përcaktore, edhe në gjuhën shqipe, edhe në atë angleze, dalin si të varura. Si pikë e parë përjashtë është vetë fjalia, tipologjia e tyre, ku struktura e fjalisë është SVO, pra Subject – Verb – Object. Në gjuhën angleze kjo strukturë është më e ngurtë, ndersa në gjuhën shqipe, më elastike. Kjo ndodh për shkak të natyrës analitike të gjuhës angleze përkundër asaj sintetike në gjuhën shqipe.

- I [S] like [V] flowers [O].

- Ushtari [Kryefj.] ngriti [kallëzues] pushkën [Objekti].

Kryefjala është gjymtyra kryesore emërore a përemërore e fjalisë dykryegjymtyrëshe që hyn në marrëdhënie e në lidhje kallëzuesore me kallëzuesin. Një përkufizim tjetër e përkufizon kryefjalën si gjymtyrën emërore ose përemërore të fjalisë që varet nga kallëzuesi, që bashkohet me të, dhe që saktëson subjektin e veprimit duke hyrë në lidhje kallëzuesore me kallëzuesin.

Përkufizime në gjuhën angleze: Kryefjala është frymori apo sendi për të cilën fjalia flet. Kallëzuesi shpesh bën një koment apo i referohet kryefjalës. Një tjetër përkufizim: Kryefjala e fjalisë është personi, sendi, vendi, ideja etj. E cila është apo bën diçka. Njeriu mund të identifikojë kryefjalën nëse mund të identifikojë kallëzuesin-foljen. Ajo që kanë të përbashkët këto përkufizime, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze, është natyra emërore apo përemërore e kryefjalës (subject) e cila funksionon si një gjymtyrë kryesore në fjali dhe shpreh kryesin e një veprimi apo përjetuesin e një gjendjeje, pra. objektin ose fenomenin të cilit fjalia i referohet.

Bibliografia dhe referencat

- Ademi, S. (2016). Some Comparative Views of Nominative, Dative and Accusative in English and Albanian Language. *ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 5(2), 82-86.
- Ademi, S. (2017). The Realization of Time Adjuncts in Albanian and English Language. *ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 6(1), 21-28.
- Aliti, A., & Iseni, A. (2014). The Contrastive Analysis of the English-ING Clause as Direct Object and its Albanian Correspondents. *European Scientific Journal*, 10(14).
- Aliti, A. (2019). The Contrastive Analysis of the English-ING Clause as Subject Complement and its Albanian Correspondents. *ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 7.

- Aliti, A., & Iseni, A. (2016). The Contrastive Analysis of the English-ING Clause as Subject of a Sentence and its Albanian Correspondents. *ANGLISTICUM. Journal of the Association-Institute for English Language and American Studies*, 2(6), 78-84.
- Aliti, A., Iseni, A., & Rexhepi, N. The Contrastive Analysis of the English-ING Clause as Prepositional Complement and Its Albanian Correspondents.
- Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997.
- Blount A. (2009) “*An elementary English Grammar*”, BiblioLife LLC
- Dalmolin H. (2009) “*The New English Grammar: with Phonetics, Morphology and Syntax*”, Tate Publishing & Enterprises, Okinawa, USA
- Chomsky. N, *Syntactic Structures*, The Hague: Mouton, 1957
- Çeliku. M, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*, ILA, 2012
- Domi. M, *Gramatika e gjuhës shqipe, pjesa II, Sintaksa, tekst për shkollën 7-vjeçare*, Tiranë, 1955.
- Domi. M, *Sintaksa e gjuhë shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1971
- Emonds. J, *Appositive Relatives Have No Properties in: Linguistic Inquiry*
- Emonds. J, *A Transformational Approach to English Syntax*, Academic Press Inc
- Floqi. S, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korrelative*, Studime filologjike, 1967/3
- Givon, T. (2001). “*Syntax: an Introduction*”, Volume 2, Philadelphia, USA
- Hemingway. E, *Plaku dhe deti*, Feniks bb & Çabej, Kërçovë, 2003
- Jackendoff. R, *X Syntax: A Study of Phrase Structure*, The MIT Press, 1977
- Mathews P.H, *The concise Oxford dictionary of linguistics*, New York : Oxford University Press, 2007
- Miller, J. (2002). “*An Introduction to English Syntax*”, Edinburgh University Press, Edinburgh
- Narayanaswamy, K.R. (2004) “*Teacher’s Grammar of English: linking a grammar with communication*”, Orient Longman ELT, India
- Nesimi, R., Toska, V. (2001). “*Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme. Sintaksa II*”, Prosvetno Dello, Shkup
- Panolli. J, *Aspekte të gramatikës përfaqëse dhe korigjuese*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2000
- Prifti S. (1971) “*Sintaksa e gjuhës shqipe*”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë
- Prifti. S, *Klasifikimi i fjalive të varura*, Studime filologjike, 1972/2
- Prifti. S, *Sintaksa e shqipes*, Tiranë, 1962
- Rardin. R, *Sentence Raisng ans Sentence Shift*, unpublished manuscript, MIT, 1968
- Renzi. L, (a cura di) *Grande grammatica italiana di consultazione. Volume I: La frase. I sintagmi nominale e preposizionale*, Bologna, Il Mulino, 1988
- Rrota. J, *Sintaksi i shqipes, për klasat II, III, IV të shkollave të mesme*, Shkodër, 1942
- Rushi, TH., “*Funksioni gramatikor i rendi të fjalëve në gjuhën shqipe*”, Studime filologjike, 1983/4.